



## Thirrje për Përfaqësues të Organizatave Joqeveritare dhe Gazetar në Kosovë

[Open Government Data Ecosystems](#) është projekt i financuar nga Ambasada e SHBA-ve në Kosovë dhe zbatohet nga Open Data Kosovo. Qëllimi kryesor i projektit është të krijoj komunikim më të fuqishëm dhe qëndrueshëm mes qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile me institucionet publike dhe të promovoj Ligjin mbi Qasjen në Dokumente Publike për qeverisje më të mirë.

Duke qenë se grupet përfituese të projektit janë: organizatat e shoqërisë civile dhe gazetarët, Open Data Kosovo po lanson dy gara (challenges) me shpërblime pikërisht për këto dy grupe.

Prandaj, nëse jeni pjesëtar të organizatave joqeveritare ose gazetar në Kosovë dhe doni të merrni pjesë në këtë garë, gjithçka që duhet të bëni është:

### *Për përfaqësuesit e organizatave:*

1. Dërgoni një koncept se si do e zhvillonit një analizë të të dhënave duke u bazuar në Ligjin mbi Qasjen në Dokumente Publike dhe përshkruani se çfare do rregullonit/riaplikonit përsëri në ndonjë shërbim ose vendim publik nga institucionet shtetërore.

2. Analiza mund të jetë në formatin e vizualizimit të të dhënave, infografikave, grafikonave dhe përmbledhjes me tekst etj.

3. Koncepti i dërguar të jetë në Word deri në 2 faqe maksimum ku spjegohet në detaje analiza që do krijohet.

4. Analiza e të dhënave duhet të përfshijë: identifikimin e problemit/përparësisë, hapësirën për ndryshim, rekomandimet.

### *Për gazetarët:*

1. Dërgoni një koncept se si do e zhvillonit një artikull të bazuar në të dhëna të hapura dhe në Ligjin mbi Qasjen në Dokumente Publike ku përshkruani se çfarë do rregullonit ose riaplikonit në ndonjë shërbim ose vendim publik të ndërmarrë nga institucionet shtetërore.

2. Artikulli duhet të jetë i gjatë deri në 5 faqe maksimum.

3. Koncepti i dërguar të jetë në Word deri në 2 faqe maksimum ku spjegohet në detaje ideja mbi artikullin, tema, shërbimi ose vendimi dhe rekomandimi.

4. Artikulli duhet të përfshijë: shërbimin ose vendimin e institucioneve publike, identifikimin e problemit/përparësisë, hapësirën për ndryshim/rekomandimet.



**Shpërblimi:** Në total do zgjedhen dy (2) artikujt më të mirë dhe dy (2) analizat e të dhënave më të mira të cilat do zhvillohen më tej dhe në fund do shpërndahen katër (4) Laptop në total, nga një Laptop për fitues. Gjithashtu, të gjitha krijimet do publikohen ne rrjetet sociale të Open Data Kosovo.

Konceptet të dërgohen në [info@opendatakosovo.org](mailto:info@opendatakosovo.org) me titull: OGDE\_Koncept\_Organizata për përfaqësuesit e organizatave dhe OGDE\_Koncept\_Gazetar për gazetar.

Afati i fundit për dërgim është: **30 Gusht 2020 deri në orën 23:59.**

Nëse aplikojnë dy përfaqësues të një organizate joqeveritare, atëherë do të konsiderohet vetëm një aplikim.

\*Open Government Data Ecosystems (OGDE) është projekt i financuar nga Ambasada e SHBA-ve në Kosovë dhe implementuar nga Open Data Kosovo.